

KËRKESË
Nr. 6785, datë 31.7.2019


PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“BASURA” SH.P.K

ISHMPUT-ja, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të dënimit nga grupi i inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar “larguar”.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Qendër, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“BASURA” SH.P.K

KRYEINSPEKTOR
Armando Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DREJTORIA QENDRORE
VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000282 - 5

Datë: 02/07/2019

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000282 - 2, datë 31/05/2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “BASURA” SHPK, NIPT K48108908H, Përfaqësues i autorizuar i subjektit SULEJMAN SINA, prej datës 27/05/2019 00:00 deri më datën 28/05/2019 00:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 31/05/2019 dhe e njoftoi në datë 31/05/2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore :
Ligji Nr. 10488, date 14.07.2011 “PËR LEJET E MJEDISIT” Neni Nr. 29 Pika 1/a/i.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Giobe 1000000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

—

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Ersid Hasanllari ID: 0300020003

Alban Kostallari ID:

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti “BASURA” SHPK ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

